



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 41, DATË 07.03.2019

PËR







MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR TRANSMETIMIN E RAPORTEVE TË SHKURTRA TË NGJARJEVE ME RËNDËSI TË MADHE PËR PUBLIKUN”

Në mbështetje të nenit 19, pika 16 dhe nenit 130 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për transmetimin e raporteve të shkurtra të ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun”, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

<b>Kryetar:</b>	<b>Gentian</b>	<b>SALA</b>	
<b>Zëvendëskryetar:</b>	<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>	
<b>Anëtarë:</b>	<b>Agron</b>	<b>GJEKMARKAJ (Në mungesë)</b>	
	<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>	
	<b>Piro</b>	<b>MISHA</b>	
	<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>	
	<b>Zylyftar</b>	<b>BREGU</b>	



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**RREGULLORE**

**"PËR TRANSMETIMIN E RAPORTEVE TË LAJMEVE TË SHKURTRA TË  
NGJARJEVE ME RËNDËSI TË MADHE PËR PUBLIKUN"**

**(Miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 41, datë 07.03.2019)**

**Neni 1  
Objekti**

Kjo rregullore përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat për transmetimin e raporteve të lajmeve të shkurtra të ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun si dhe kohëzgjatjen e transmetimit të tyre në zbatim të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

**Neni 2  
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregullore është realizimi i së drejtës së transmetimit të njoftimeve të shkurtra, me qëllim garantimin e së drejtës së informimit për ngjarjet me rëndësi të madhe për publikun.

**Neni 3  
Baza ligjore**

Dispozitat e kësaj rregullore hartohen në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si edhe të çdo akti tjetër nënligjor që nuk bie ndesh me parimet e kësaj rregullore.

**Neni 4  
Përkufizime**

Termtat e përdorur në këtë rregullore do kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe në rast se nuk janë të përkufizuar në ligj, do të jenë në përputhje me direktivat e BE për komunikimet elektronike, AVMSD (Direktiva për Shërbimin Mediatic me Zë dhe Figurë), që rregullojnë fushën.

Në këtë rregullore termtat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- 197
1. "Raportet e lajmeve të shkurtra" janë njoftimet për ngjarjet me rëndësi të madhe për publikun, me kohëzgjatje jo më shumë se 90 sekonda, të cilat transmetohen në programet e lajmeve të përgjithshme dhe mund të përdoren në shërbimet mediatike audiovizive sipas kërkesës, vetëm nëse i njëjti program ofrohet mbi një bazë më të vonë nga i njëjti ofruer shërbimi mediatik audioviziv.
  2. "Ngjarje me rëndësi të madhe" është një ngjarje me rëndësi publike në Shqipëri, ose në një pjesë të saj, me natyrë sportive ose josportive, e cila përmbush të paktën dy nga kushtet e mëposhtme:
    - a) për ngjarjen ka një interes të veçantë dhe të përhapur në vend, ku personat e interesuar janë edhe të tjerë, përveç atyre, të cilët zakonisht ndjekin ngjarje të tilla përmes televizionit;
    - b) ngjarja gëzon njohje të gjerë nga publiku i përgjithshëm, ka një ndikim kulturor të rëndësishëm, forcon identitetin kulturor dhe nuk ka përmbajtje partiake;
    - c) ngjarja përfshin pjesëmarrjen e skuadrës kombëtare të një discipline sportive të veçantë, në një ngjarje ose garë të rëndësishme ndërkombëtare;
    - d) ngjarja historikisht është transmetuar pa pagesë përmes televizionit dhe ka pasur një shikueshmëri të lartë në vend.
  3. "Ofruer shërbimi mediatik audioviziv (OSHMA)" është personi fizik ose juridik, që ka përgjegjësinë editoriale për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit audioviziv dhe që vendos mënyrën e organizimit të saj.
  4. "Organizues i ngjarjes" është personi fizik ose juridik, që ka të drejtën ligjore për shitjen dhe shpërndarjen e ngjarjes.
  5. "Të drejta ekskluzive" janë të drejta që janë fituar nga OSHMA në bazë të një marrëveshje/kontratë nga mbajtësit e të drejtave të tyre.

## Neni 5

### Parimet e përgjithshme në raportet e shkurtra

Të gjithë OSHMA-të në territorin e Republikës së Shqipëri kanë të drejtën për akses në ngjarje me rëndësi të madhe për publikun, në kushte të barabarta. Kjo e drejtë duhet të ushtrohet në mënyrë të paanshme, jo diskriminuese për të gjithë OSHMA-të në territorin shqiptar sipas kontratave të lidhura me mbajtësit e të drejtave të transmetimit në territor.

## Neni 6

### E drejta për raporte të shkurtra

1. Nëse OSHMA-ja që operon në territorin e Republikës së Shqipërisë ka fituar të drejta ekskluzive për ngjarje me interes të lartë për publikun, një tjetër OSHMA, i krijuar në Shqipëri, mund të kërkojë prej tij akses për ngjarjen në fjalë.
2. Çdo OSHMA i krijuar në Bashkimin Europian, Maqedoni, Mal i Zi dhe Kosovë ka akses me kushte të barabarta në raportime të shkurtra në ngjarjet me rëndësi të madhe për publikun, të cilat transmetohen mbi baza ekskluzive nga një OSHMA nën juridiksionin e Shqipërisë.
3. OSHMA që do të transmetojë raporte të shkurtra të ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun, ka të drejtë të zgjedhë lirisht pjesë të shkurtra nga sinjali i emtuar prej OSHMA-

së së përcaktuar për transmetimin e kësaj ngjarje, duke identifikuar burimin e tyre, në mënyrë verbale dhe shfaqjen e pamjeve me logon e mbajtësit së të drejtave.

- 4. Për evente të caktuara sportive për të cilat, raportet e shkurtra përcillen nga organizuesi ngjarjes dhe të drejtat që blihen nga një OSHMA në Shqipëri, raportet e shkurtra përcillen për çdo OSHMA, siç i përcjell organizatori.
- 5. OSHMA, për raportimet e shkurtra të ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun, në rastet kur këtë raportim e shoqëron me pamje/video/sequenca, duhet të ketë marrëveshje me OSHMA-në, që zotëron të drejtën ekskluzive për transmetimin e ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun në territorin e Republikës së Shqipërisë.

### Neni 7

#### Koha dhe mënyra e transmetimit të raporteve të shkurtra

- 1. Koha e transmetimit dhe/ose ritransmetimit të raporteve të shkurtra të ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun, përcaktohet në kontratën e të drejtës së transmetimit midis OSHMA-ve dhe OSHMA-së, i cili zotëron të drejtën ekskluzive për transmetimin e ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- 2. Nëse një ngjarje me interes të lartë për publikun zhvillohet gjatë dy ose më shumë ditëve, OSHMA ka të drejtë për raporte të shkurtra për çdo ditë.

### Neni 8

#### Detyrimet

OSHMA-ja që transmeton ngjarjen me rëndësi të madhe për publikun ka të drejtë të kërkojë nga OSHMA-ja që transmeton raporte të shkurtra të ngjarjeve me rëndësi të madhe, kompensimin e kostos faktike për përmbushjen e këtij detyrimi. Kompesimi i parashikuar nuk duhet të tejkalojë kostot shtesë, të shkaktuara drejtpërdrejt nga lejimi i aksesit.

### Neni 9

#### Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet

- 1. Të gjithë OSHMA-të janë të detyruar të respektojnë dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në këtë rregullore.
- 2. Mosrespektimi i dispozitave të kësaj rregulloreje mbi transmetimin e raporteve të shkurtra të ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun dhe/ose transmetimin pa të drejta, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 1 000 000 lekë deri në 2 000 000 lekë.

### Neni 10

#### Kundërshtimi në gjykatë

Kundër vendimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive për dënimin me gjobë mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

156

**Neni 11**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga Autoriteti i Mediave Audiovizive.

**Neni 12**  
**Publikimi**

Kjo rregullore publikohet nga Autoriteti i Mediave Audiovizive në faqen zyrtare të internetit [www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al).